



**Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri**

Konferencë për Shtyp

**Ambasadori Osmo Lipponen, Kryetari i Prezencës
24 shkurt 2004**

Unë nisem sot në Vjenë për të raportuar para Këshillit të Përhershëm të OSBE-së mbi zhvillimet më të fundit në vend dhe planet për Prezencën në vitin 2004. Në këtë udhëtim, unë do të jem i shoqëruar nga Ambasadori i Delegacionit të Komisionit Evropian, Lutz Salzmann. Edhe Ministri i Punëve të Jashtme Kastriot Islami do të jetë i pranishëm në Vjenë për të folur para Këshillit të Përhershëm në të njëjtën ditë.

Negociatat për rifreskimin e mandatit të Prezencës përfunduan me sukses në fund të vitit të kaluar falë dialogut të ngushtë midis Prezencës dhe qeverisë. Mandati i ri i jep Prezencës një bazë të fortë për vazhdimin e rolit të saj në vend.

Që nga raporti ynë i fundit, paraqitur në muajin nëntor, Prezenca ka vazhduar t'i kushtojë burime të konsiderueshme mbulimit të përsëritjeve të zgjedhjeve, si dhe ndjekjes së ecurisë së projektligjit për pronat në Kuvend. Gjatë kësaj kohe, Prezenca ka përfunduar edhe analizën e saj të plotë të sistemit ligjor dhe gjyqësor në Shqipëri, e cila u publikua javën e kaluar, si dhe ka filluar të mbështesë Kuvendin në rishikimin e Rregullores së tij.

Në situatën aktuale politike, e cila për fat të keq ka parë një mosfunksionim të vullnetit politik, nuk mund të harrojmë proceset e rëndësishme të reformave që janë në zhvillim e sipër. Mes të tjerave, çështje të rëndësishme si reforma zgjedhore, kthimi i pronave dhe reforma territoriale, kërkojnë arritjen e një marrëveshjeje të gjerë politike. Vendimmarrja duhet të vazhdojë të jetë transparente dhe gjithëpërfshirëse. Pikërisht këtu, roli i Prezencës si lehtësuese për të mbështetur procesin politik, mbetet shumë i rëndësishëm.

Me daljen pas pak ditësh të *Raportit Përfundimtar* të ODIHR-it për zgjedhjet e qeverisjes vendore, Prezenca do të fillojë konsultimet politike për të rifilluar vazhdimin e pritshëm të reformës zgjedhore.

Prezenca u inkurajua nga fakti që si opozita, ashtu dhe qeveria i trajtuan demonstrimet e së shtunës me pjekuri dhe përgjegjësi. Unë besoj se ky është një tregues që të gjitha palët janë të gatshme t'i trajtojnë sfidat e Shqipërisë brenda kufijve të procesit demokratik. Ne presim që edhe në të ardhmen të shohim qëndrime të ngjashme.

Sukseset e fundit të grupeve zëfuqishme të shoqërisë civile si Mjaft! dhe Zyrës së Mbrojtjes së Qytetarëve, ashtu si dhe sindikatave, shoqatave të biznesit dhe të tjera, është një shenjë pozitive që demokracia po zhvillohet në Shqipëri. Fakti që shprehja e publikut

nuk është më një privilegj i ngushtë i partive politike përbën një zhvillim që është mirëpritur. Letra e hartuar së fundi nga një grup OJQ-sh, nëpërmjet së cilës i kërkohej politikanëve të tregojnë më shumë përgjegjësi dhe respekt në Kuvend është një tjetër shembull.

Duke pasur parasysh këtë, Prezenca do të përfshijë një sërë temash në punën e saj gjatë gjithë vitit, si *transparenca* dhe *pjesëmarrja e publikut në qeverisje*. Përveç kësaj, Prezenca do t'i kushtojë një vëmendje të madhe edhe çështjes së barazisë gjinore, duke pasur parasysh sidomos rënien zhgënjyese dhe të vazhdueshme të grave në politikë.

Qëllimi i përgjithshëm i Prezencës në Shqipëri vazhdon të jetë mbështetja e demokratizimit, shtetit ligjor dhe të drejtave të njeriut. Për të përmbushur këtë qëllim, Prezenca po punon në fushat reformës legjislativë dhe gjyqësore, ku përfshihen kthimi dhe kompensimi i pronave, reforma rajonale administrative, reforma zgjedhore, forcimi i kapaciteteve të Parlamentit, veprimtaritë kundër trafikimit dhe korrupsionit, zhvillimi i medias, zhvillimi i shoqërisë civile dhe asistenca për policinë.

Pyetjet & Përgjigjet

Pyetje: Z.Ambasador, a mund të na thoni diçka më shumë rreth situatës politike në Shqipëri, rreth reformave që ju keni monitoruar, diçka nga raporti që ju do të mbani në Këshillin e Përhershëm? A do të bëni ju një vlerësim rreth situatës politike në Shqipëri?

Përgjigje: Sigurisht që do të ketë një vlerësim të situatës, por sipas rregullave të OSBE-së, unë nuk mund të komentoj në mënyrë më të detajuar para se raporti të mbahet në Këshillin e Përhershëm, sepse është Këshilli ai që autorizon këtë raport.

Pyetje: Z.Ambasador, a shihni ndryshime që nga raporti juaj i fundit në qershor, ku ju theksuat se prisnit trazira sociale për shkak të rënies ekonomike?

Përgjigje: Më duhet t'ju kujtoj se unë kam paraqitur një raport tjetër pas atij të qershorit. Në raportin e fundit, unë shpreha një lloj shqetësimi rreth një rënieje të klimës konsensuale. Përsa i përket situatës ekonomike dhe sociale, nuk ka pasur ndryshime të shpejta në këtë drejtim. Ka pasur një rritje të vazhdueshme, por siç ndodh shpesh, kategoritë më të pafavorizuara të shoqërisë kanë përfituar shumë pak nga kjo rritje. Gjithashtu, rritja është përqendruar shumë në zonën e kryeqytetit të vendit. Kështu, ndërsa ka një lloj përparimi, numri i atyre që jetojnë vërtetë në rrethana shumë të vështira sociale dhe ekonomike është jashtëzakonisht i lartë.

Pyetje: Kur thoni se duhet arritur një marrëveshje e gjerë politike për të zbatuar reformat e ndryshme, si reforma zgjedhore, reforma rajonale administrative, etj, a doni të thoni se janë z.Berisha dhe z.Nano ata që duhet të ulen e të arrijnë këtë marrëveshje apo ka edhe faktorë të tjerë që do të ndikojnë?

Përgjigje: Sigurisht, nëse përpiqesh të arrish një konsensus sa më të gjerë që të jetë e mundur për këto çështje kyçe, do të thotë në njëfarë mënyre, se partitë kryesore duhet të arrijnë një marrëveshje. Më e mira do të ishte që liderët të ulëshin së bashku, siç besoj se do të ndodhë. Ose të paktën të ketë një diskutim indirekt midis tyre, sepse duhet të ketë një marrëveshje për mënyrën se si duhet të vazhdojë procesi. Janë zhvilluar tashmë disa diskutime, në të cilat kemi trajtuar gjërat kryesore, dhe unë besoj se do të ketë gatishmëri nga të dyja palët. Opozita e ka shprehur tashmë gatishmërinë e saj dhe me sa kuptoj qeveria ka qënë gjithmonë e gatshme, të paktën për sa i përket reformës zgjedhore.

Pyetje: Ju patët një takim së fundi me Kryeadministratorin e Kosovës, Harri Holkeri. A mund të na tregoni diçka më shumë rreth temave që ju diskutuat?

Përgjigje: Kur takohen by bashkëkombas, gjërat e para diskutohen në fillim. Këshilltari Numër 1 i Holkerit ka qënë edhe këshilltari im numër 1. Sigurisht, folëm në fillim për të, se si i kanë shkuar punët. Diskutuaam gjithashtu edhe për përgatitjet për takimet e ardhshme, si dhe shkëmbyem mendime se si e shohim situatën në rajon. Kemi gjithashtu edhe disa ide se si mund të rrisim bashkëpunimin në të ardhmen. Së shpejti, unë do të vizitoj Kosovën dhe ekipin e Holkerit.

Pyetje: Z.Ambasador, çfarë keni parasysh kur thoni se ka pasur një prishje të vullnetit politik? Çfarë do t'i sugjeronit partive politike, pasi mesa duket deri tani, marrëveshja e vetme për opozitën është arritja e një qeverie teknike?

Përgjigje: Mendoj se po përpiqeni të ngatërroni disa gjëra që nuk i përkasin njëra-tjetrës. Është e qartë se fryma konsensuale jashtëzakonisht konstruktive që kishim gjatë dimrit dhe pranverës së kaluar, që rezultoi në Kodin e ri Zgjedhor, në një përpjekje për të zgjidhur çështjen e kthimit të pronave dhe krijimin e Grupit të Ekspertëve Teknikë të drejtuar nga OSBE-ja, pra kjo pjesë faktikisht normale e parlamentarizmit, u bë shumë e vështirë ndërsa afroheshin zgjedhjet për pushtetin vendor, pasi disa marrëveshje mbi zbatimin e punës së komisionit bipartizan nuk u zbatuan. Përveç kësaj, kjo ndikoi edhe në klimën politike, dhe praktikisht pothuajse çoi në mosfunksionimin [e vullnetit] politik. Ka edhe tregues të tjerë që kanë ndikimin e tyre mbi situatën. Fundi i vitit të kaluar në politikë ishte shumë i vështirë, por në njëfarë mënyre duket se tani jemi në rrugën e duhur. Kjo, sigurisht që do të testohet në javët e ardhshme.

Pyetje: Z.Ambasador, para se të largoheni për Vjenë, a mund të na jepni vlerësimin tuaj individual për situatën politike në Shqipëri?

Përgjigje: Unë e kam dhënë vlerësimin tim. Në këtë pozicion, nuk mund të kesh edhe opinione personale edhe zyrtare. Ke vetëm një opinion. Ai bazohet në parimet e OSBE-së dhe mandatin tonë. Megjithatë, unë mund të them se detyra është e vështirë, por ka shpresë.